



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 197/ prot.

Elbasan, më 31.01.2024

VENDIM
Nr. 2 datë 31.01.2024

**"PËR
MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE, STRUKTURËS ORGANIZATIVE DHE
NIVELIT TË PAGAVE PËR ÇDO POZICION PUNE NË UNIVERSITETIN E
ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; VKM-n nr. 243, datë 20.04.2023 "Për disa ndryshime në VKM nr. 748 datë 11.06.2009 'Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë'", VKM Nr. 325, date 31.05.2023, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civile /nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike"; VKM Nr. 326, date 31.05.2023 , "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore"; Udhëzimit të MFE Nr. 16, datë 16.06.2023, "Për mënyrën e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civile / nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike"; Udhëzimit nr 27 datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë", Vendimit të Senatit Akademik Nr. 33 , datë 09.11.2021 "Për miratimin e strukturës së përgjithshme të të Universitetit të Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'", i ndryshuar, VBA nr. 49, datë 13.11.2021 "Për miratimin e numrit të personelit dhe pagat për të gjitha nivelet në Universitetin Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'", i ndryshuar, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Numri i përgjithshëm i personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" të jetë 376 punonjës; personel akademik 247 punonjës, personel ndihësakademik/administrativ 129 punonjës,
2. Struktura organizative dhe niveli i pagave për secilin pozicion pune të jetë, si në tabelën e mëposhtme:
3. Paga për secilin pozicion të jetë sa përcaktimet në vendimarrjet për nivelin e pagave. Efektet financiare për pozicionin e nivelit minimal të përballohen nga fondet e grantit të mësimdhënies, ndërsa Efektet financiare deri në pozicionin e nivelit maksimal të përballohen nga fondet e grantit për rimbursimin e të ardhurave të pagrumbulluara si efekt i zbatimit të VKM-ve dhe nga të ardhurat e grumbulluara.
4. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit të Universitetit për procedura të mëtejshme. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Prof. Dr. Skender Topi

